



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 68, datë 21.03.2023

- Ankues:** Zoti Ilir Hoxha  
*Prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Sarandë*
- Objekti:**
1. Kërkohet shpallja e pabazueshmërisë së neneve 3.2 dhe 4.1 të Udhëzimit të Përgjithshëm Nr. 1, datë 25.01.2023, të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë, për nenin 221, paragrafi 1, germa “a”, të Kodit të Procedurës Penale.
  2. Kërkohet shfuqizimi i neneve 3.2 dhe 4.1 të Udhëzimit të Përgjithshëm Nr. 1, datë 25.01.2023, të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Sarandë.
- Baza Ligjore:**
1. Kodi i Procedurave Administrative;
  2. Ligj Nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë” i ndryshuar;
  3. Ligji Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
  4. Udhëzimi i Përgjithshëm Nr. 4, datë 26.10.2018 “Për përgjimet”, i Prokurorit të Përgjithshëm;
  5. Udhëzimi i Përgjithshëm Nr. 12, datë 20.07.2020 “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm” i ndryshuar;

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Bazuar në nenin 47, pika 1 të ligjit Nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë” i ndryshuar, pasi dëgjoji raportimin e anëtarit Tartar Bazaj, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

**Rrethanat e çështjes**

- 1.1 Drejtuesi i Prokurorisë z. Kledian Llaho, me qëllim mirëfunksionimin dhe njësimin e punës në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë si dhe garantimin e zbatimit korrekt të Udhëzimit të Përgjithshëm Nr. 4, datë 26.10.2018 “Për përgjimet” të Prokurorit të Përgjithshëm, bazuar në nenin 43, germa “dh” e ligjit Nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë” të ndryshuar, ka nxjerrë Udhëzimin e Përgjithshëm Nr. 1, datë

25.01.2023 *“Për aplikimin e drejtë të normës procedurale nga prokurorët në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë”.*

- 2.1 Duke marrë në konsideratë, se nga prokurorët e Prokurorisë Sarandë ka pasur qëndrime dhe interpretime të ndryshme mbi kuptimin e togfjalëshit *“... për të cilat parashikohet dënim me burgim jo më pak, në maksimum, se shtatë vjet”*, udhëzimi i përgjithshëm detyrues i prokurorit më të lartë synon të njësoj veprimtarinë hetimore të prokurorëve gjatë ushtrimit të ndjekjes penale, në lidhje me interpretimin dhe zbatimin kufijve të përgjimit, të parashikuar nga neni 221, pika 1, germa “a”, të Kodit të Procedurës Penale.
- 3.1 Këshilli i Lartë i Prokurorisë, nëpërmjet shkresës Nr. 256 Prot., datë 15.02.2023, ka administruar ankesën e prokurorit Ilir Hoxha, i cili kundërshton ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e Udhëzimit të Përgjithshëm Nr. 1, datë 25.01.2023 *“Për aplikimin e drejtë të normës procedurale nga prokurorët në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë”*. Ankesa është mbështetur në nenin 47, pika 1, të ligjit Nr. 97/2016 *(i ndryshuar)*, duke parashtruar që udhëzimi vjen në kundërshtim me nenin 221 të Kodit të Procedurës Penale.

## II

### Pretendimet e ankuesit

- 4.1 Dispozitat e Kodit Penal që janë përcaktuar në nenin 3.2 të Udhëzimit të Përgjithshëm Nr. 1, datë 25.01.2023, të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë, rezulton se ato kanë të përbashkët midis tyre masën e dënimit me burgim e cila përcaktohet në *“burgim ... gjer në shtatë vjet”* apo *“burgim ... deri në shtatë vjet”*.
- 5.1 Në kuptimin gjuhësor, parafjala *“gjer”* e përdorur në parashikimin në dispozitave përkatëse *“burgim.. gjer në shtatë vjet”* është sinonim i parafjalës *“deri”* që përdoret në dispozitat e tjera. Në konsultë me Fjalorin e Gjuhës Shqipe, botim i vitit 1984 të Akademisë së Shkencave, rezulton se parafjala *“deri – përdoret me ... një emër në rasën kallëzore (të privë ose jo nga një numër themelor), për të treguar cakun kohor kur kryhet një veprim, çastin përfundimtar kur mbaron diçka a kohën sa zgjat një veprim”*.
- 6.1 Kështu, përballë parashikimit në dispozitat e Kodit Penal, të përcaktuara në nenin 3.2 të Udhëzimit të Përgjithshëm Nr. 1, datë 25.01.2023, të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë, të masave të dënimit *“burgim ... gjer në shtatë vjet”* apo *“burgim ... deri në shtatë vjet”*, duke marrë në konsideratë kuptimet gjuhësore të parafjalëve *“gjer”* dhe *“deri”*, sa më sipër evidentuar, rezulton qartë se masa e dënimit shkon deri në *“shtatë vjet”*, por pa e arritur dhe konsumuar cakun e shtatë viteve burgim. Në këtë kuptim, dënimi maksimal *“gjer në shtatë vjet”*, apo *“deri në shtatë vjet”* shkon deri në kufirin maksimal prej 6 vitesh, 11 muaj e 30 ditë e barabartë me 2,554 ditë burgim, pa arritur dhe konsumuar dënimin prej shtatë vitesh.
- 7.1 Bazuar në këtë arsyetim, përcaktimi tek Udhëzimi i Përgjithshëm Nr. 1, datë 25.01.2023, i Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë, se *“dënimi me maksimum shtatë vjet burg”*, masë dënimi kjo që përfaqësohet nga 6 vjet, 11 muaj e 30 ditë, e barabartë me 2,554 ditë burgim, si është parashikuar në nenin 3.2, përfaqëson një përkufizim të gabuar, që rrjedh nga një perceptim dhe përdorim i gabuar i parafjalës *“me”* duke passjell edhe një udhëzim të gabuar.
- 8.1 Kështu, në asnjërin prej dispozitave të Kodit Penal të përcaktuar në nenin 3.2 të Udhëzimit të Përgjithshëm Nr. 1, datë 25.01.2023, të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë, nuk është parashikuar si masë dënimi me burgim *“dënimi me*



*maksimum 7 (shtatë) vjet burg*”, sikurse evidentohet tek udhëzimi i kundërshtuar. Në konsultë me Fjalorin e Gjuhës Shqipe, parafjala “*me*” ka kuptimin “*përdoret me një emër ose me një përemër në rasën kallëzore për të treguar... sasi ose masë të caktuar*”. Vënia e shenjës së barazisë ndërmjet kuptimeve që kanë fjalët “*gjër*” dhe “*deri*” me parafjalën “*me*”, passjell natyrshëm perceptim dhe përdorim të gabuar të udhëzimit të kundërshtuar.

- 9.1 Nëpërmjet parashikimit të nenit 221, pika 1, germa “*a*”, të Kodit të Procedurës Penale, fjalia “*për krimet ... , për të cilat parashikohet dënim me burgim jo më pak, në maksimum, se shtatë vjet*”, ligjvënësi ka vendosur një kufizim në lidhje me aplikimin e përgjimit si mjet i kërkimit në proces, duke e kufizuar atë në aplikimin karshi një numri të caktuar veprash penale që përfaqësohen pikërisht nga ato vepra penale që kanë si marzh dënimi “*burgim jo më pak, në maksimum*” se shtatë vjet”.
- 10.1 Në kuptim gjuhësor, në konsultë me Fjalorin e Gjuhës Shqipe, rezulton se ndajfolja “*më* – shërben për të formuar shkallën krabasore e sipërore relative të mbiemrave, shkallën krabasore të ndajfoljeve dhe shprehje ndajfoljore që shënojnë shkallën më të lartë të veprimit a të gjendjes”. Përdorimi i ndajfoljes “*më*” në togfjalëshin “*jo më pak*”, e bën në kuptimin gjuhësor, togfjalëshin “*jo më pak*” sinonim të parafjalëve “*nga*” ose “*prej*”, të cilat, në konsultë me Fjalorin e Gjuhës Shqipe, rezulton se kanë kuptimet respektivisht: “*nga – përdoret me një emër në rasën emërore, për të treguar... vendin prej të cilit nis lëvizjen dikush a diçka ose prej ku vjen dikush a diçka; burimin prej ku del diçka*”, dhe “*prej – përdoret me një emër në rasën rrjedhore për të treguar... vendin nga vjen, nga nis lëvizjen dikush a diçka; burimi nga del diçka*”.
- 11.1 Kështu togfjalëshi “*jo më pak*” do të thotë se masa e dënimit do të jetë “*në maksimum*”, “*burgim jo më pak se shtatë vjet*”, çka do e përkthejë këtë dënim “*në maksimum*” me burgim në shtatë vjet, dhe në vijim nga shtatë vjet e një ditë, duke mos u kufizuar në masën maksimale të dënimit, masë dënimi kjo që mund të shkojë deri tek dënimi me burgim të përjetshëm. I përkthyer në ditë dënimi me burgim, termi “*burgim jo më pak se shtatë vjet*” do të përkthehet në 2,555 ditë burgimi.
- 12.1 Edhe në konceptimin e boshtit numerik, përcaktimet e masave të dënimit “*burgim... gjër në shtatë vjet*” apo “*burgim...deri në shtatë vjet*”, si dhe “*burgim jo më pak, në maksimum, se shtatë vjet*”, do të jenë në një formë të tillë ku ato do të jenë në kufij me njëra tjetrën por pa u kontaktuar apo mbivendosur me njëra tjetrën.
- 13.1 Bazuar në këto arsyttime, përcaktimi tek neni 3.2 i Udhëzimit të Përgjithshëm Nr. 1, datë 25.01.2023, të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë, përfaqëson një udhëzim që vjen në kundërshtim me parashikimin e nenit 221, pika 1, germa “*a*” e Kodit të Procedurës Penale, dhe si e tillë duhet të shfuqizohet pjesërisht nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Paralelisht, parashikimi i nenit 4.1 përfaqëson një udhëzim që mbetet pa objekt, dhe si i tillë duhet të shfuqizohet.

### III

#### Vlerësimi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë

##### A. Për legjitimitimin e ankuesit

- 14.1 Ankuesi Ilir Hoxha është emëruar në detyrë në datën 04.06.2015 dhe aktualisht ushtron detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë. Si bartës i të drejtës së parashikuara nga neni 47, pika 1 i ligjit Nr. 97/2016 “Për organizimin dhe

*funksionimin e Prokurorisë” të ndryshuar, ankuesi legjitimohet ratione personae për kundërshtimin e ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së Udhëzimit të Përgjithshëm.*

- 15.1 Për sa i përket legjitimitimit *ratione temporis*, Këshilli i Lartë i Prokurorisë konstaton se ligji nuk përcakton një afat për kundërshtimin e një udhëzimi të përgjithshëm. Nisur nga ky fakt, për shkak të mungesës së një afati kohor të parashikuar nga ligji, Prokurori i Përgjithshëm nëpërmjet Udhëzimit të Përgjithshëm Nr. 12, datë 20.07.2020 *“Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”* të ndryshuar, ka përcaktuar se afati i ankimit është brenda 30 ditëve nga data kur ankuesi ka marrë njoftim për nxjerrjen e udhëzimit, referuar nenit 132 të Kodit të Procedurave Administrative. Këshilli i Lartë i Prokurorisë vlerëson se ankesa e prokurorit është paraqitur brenda afatit kohor.
- 16.1 Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, ankuesi kundërshton nenin 3.2 të Udhëzimit të Përgjithshëm Nr. 1, datë 25.01.2023 *“Për aplikimin e drejtë të normës procedurale nga prokurorët në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë”*, të Drejtuesit të Prokurorisë. Këshilli i Lartë i Prokurorisë vlerëson se kontrolli administrativ i udhëzimeve të përgjithshme është i kufizuar vetëm përsa i përket kundërshtimit të paligjshmërisë apo të pabazueshmërisë. Në çështjen objekt shqyrtimi, Këshilli i Lartë i Prokurorisë vlerëson se ankuesi pretendon se Udhëzimi i Përgjithshëm i Drejtuesit të Prokurorisë vjen në kundërshtim me nenin 221, pika 1, germa “a” të Kodit të Procedurës Penale, për rrjedhojë ankesa legjitimohet *ratione materiae*.
- 17.1 Kriteret për pranueshmërinë e ankimit të prokurorit janë kumulative, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
- 18.1 Në përfundim, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, në zbatim të nenit 44, pika 2 të Kodit të Procedurave Administrative, pasi shqyrtoi paraprakisht ankimin e prokurorit Ilir Hoxha, në funksion të plotësimit të kushteve formale dhe substanciale të pranueshmërisë së tij, vlerëson se ankimi objekt shqyrtimi plotëson kërkesat e ligjit për t’u pranuar dhe shqyrtuar administrativisht.
- B. *Në lidhje me pretendimin se Udhëzimi i Përgjithshëm është në kundërshtim me nenin 221, pika 1, germa “a” e Kodit të Procedurës Penale*
- 19.1 Juridiksioni administrativ i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, e merr natyrën dhe kufirin e shqyrtimit për kontrollin e ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së udhëzimeve të përgjithshme detyruese të prokurorit më të lartë, drejtpërdrejt nga neni 47, pika 1 ligjit nr. 97/2016 *“Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë”* i ndryshuar. Interpretimi i ligjit material e substancial si dhe analiza e jurisprudencës është ndër funksionet më të rëndësishme të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të cilin ai e ushtron sa herë që vihet në lëvizje për t’u shprehur mbi ankesat e prokurorëve që kundërshtojnë paligjshmërinë apo pabazueshmërinë e udhëzimeve të përgjithshme.
- 20.1 Kontrolli administrativ, në çdo rast, nuk mund të bëhet pa interpretimin e kuptimit të normave ligjore që lidhen me çështjen konkrete në shqyrtimin administrativ. Interpretimi që bën Këshilli i Lartë i Prokurorisë nuk ka si qëllim shtimin e normave të reja në sistemin e normave detyruese ligjore, por deklarimin ose pohimin e përmbajtjes së këtyre normave. Për të shmangur çdo mundësi për ndërhyrje në kompetencat e Prokurorit të Përgjithshëm, legjislatorit apo gjyqësorit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë nuk merr përsipër të luaj rol aktiv

në ushtrimin e këtyre kompetencave, por synon t'u japë jetë normave ligjore përmes kuptimit të drejtë të përmbajtjes dhe qëllimit të tyre.

- 21.1 Njëpërmjet interpretimit që u bën normave ose termave konkretë të ligjit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë përcakton standardet kushtetuese mbi të cilat duhet të mbështetet veprimtaria e prokurorisë gjatë ushtrimit të kompetencave ligjore të saj. Në këto raste, Këshilli i Lartë i Prokurorisë bën një vlerësim të natyrës kushtetuese të interpretimit të ligjit objekt shqyrtimi, i cili ndihmon drejtpërdrejtë për të vendosur nëse udhëzimi i përgjithshëm detyruës është i ligjshëm dhe i bazueshëm.
- 22.1 Këshilli i Lartë i Prokurorisë vlerëson se ankimi i prokurorit Ilir Hoxha lidhet vetëm me kuptimin literal dhe gramatikor të togfjalëshit *“dënim me burgim jo më pak, në maksimum, se shtatë vjet”* të parashikuar nga neni 221, pika 1, germa “a” e Kodit të Procedurës Penale. Ankuesi pretendon se neni 3.2 i Udhëzimit të Përgjithshëm Nr. 1, datë 25.01.2023, të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë, ka përfshirë gabimisht vepra penale të cilat në pjesën e dispozitivit përfshijnë togfjalëshat *“burgim... gjer në shtatë vjet”* apo *“burgim... deri në shtatë vjet”* duke argumentuar se për këto vepra penale masa e dënimit shkon deri në *“shtatë vjet”*, por pa e arritur dhe konsumuar cakun e shtatë viteve burgim.
- 23.1 Në vështrim të standardeve të shtetit të së drejtës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë kur ndodhet para mundësisë së interpretimit të një dispozite të Kodit të Procedurës Penale, në më shumë se një mënyrë dhe vetëm njëra prej këtyre interpretimeve është në pajtim me Kushtetutën, zgjedh këtë të fundit. Kjo metodë kërkon efektet kushtetuese të rezultateve të ndryshme dhe përzgjedh rezultatit që është në pajtim me vlerat kushtetuese, duke marrë parasysh këtu parimet e shtetit të së drejtës, interesin më të lartë të sistemit të prokurorisë si dhe të drejtat themelore të individëve. Gjithashtu, Këshilli i Lartë i Prokurorisë nisat nga premisa që një normë ligjore duhet të interpretohet në kuptimin që lejon zbatimin e saj, jo në atë që e përjashton këtë zbatim<sup>1</sup> (*shih vendimet Nr. 7, datë 24.02.2016, Nr. 29, datë 31.05.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).
- 24.1 Në nenin 3.2 Udhëzimi i Përgjithshëm Nr. 1, datë 25.01.2023, i Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë parashikon: *“Veprimet procedurale sipas pikës 3.1 të këtij udhëzimi, duke qenë se nga prokurorët e kësaj Prokurorie ka qëndrime dhe interpretime të ndryshme mbi kuptimin e togfjalëshit “për të cilat parashikohet dënim me burgim jo më pak, në maksimum, se shtatë vjet”, duhet të aplikohen edhe për vepra penale të cilat Kodi Penal i ndëshkon me masë dënimi me maksimum 7 (shtatë) vjet burgim ...”*.
- 25.1 Duke bërë një interpretim gramatikor të aktit të kundërshtuar, konstatohet se problematika lidhet me përfshirjen e veprave penale të parashikuara në Kodin Penal, të cilat në pjesën e dispozitivit, në maksimumin e tyre, përfshijnë togfjalëshat *“burgim... gjer në shtatë vjet”* apo *“burgim... deri në shtatë vjet”*. Termi *“gjer”* referuar Fjalorit të Gjuhës Shqipe është një parafjalë që ka kuptim të njëjtë me fjalën *“deri”*. Ndërsa, termi *“deri”* ka disa kuptime, ku ndër të tjera, përdoret me një numër themelor ose me një përemër që tregon masë a sasi të pacaktuar, për të shënuar kufirin e fundit të madhësisë ose të sasisë së vendeve, frymorëve etj.
- 26.1 Kjo analizë vjen në zbatim të respektimit të standardeve të vendosura nga Gjykata Kushtetuese, në rastet e zbatimit të teknikës së interpretimit pajtues. Gjithashtu, me shfuqizimin si antikushtetues të dënimit me vdekje, ligjvënësi shqiptar ka rishikuar dispozitat e Kodit Penal në frymën e parimeve kushtetuese dhe të Konventës Evropiane të

<sup>1</sup> *Actus interpretandus est poitius ut valeat quam ut pereat*

27/1  
S'EKRETI

- të Drejtave të Njeriut, duke u shmangur nga dënimet fikse dhe duke u orientuar drejt sanksioneve penale me një minimum dhe një maksimum të përcaktuar qartë.
- 28.1 Edhe nëse *ad absurdum* do të pranohet që interpretimi gramatikor i përdorur më lart nuk çon në këtë rezultat, vjen në ndihmë interpretimi logjik, pra nxjerra në pah e qëllimit (*ratio*) të normës ligjore. Në këtë drejtim, pavarësisht paqartësive që mund të lindin nga interpretimi literal i tekstit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë vlerëson se qëllimi i togfjalëshit “*..dënim me burgim jo më pak, në maksimum, se shtatë vjet*” i parashikuar nga neni 221, pika 1, germa “a” e Kodit të Procedurës Penale, është për të shënuar kufirin (*shtatë vjet*) për lejimin e përgjimit, duke shërbyer si një bazë për veprimtarinë hetimore të prokurorit. Në të njëjtën kohë, togfjalëshi “*gjer në shtatë vjet*” dhe “*deri në shtatë vjet*” e përdorur nga Kodi Penal, shënon kufirin e fundit të viteve të burgimit, konkretisht shtatë vjet.
- 29.1 Këshilli i Lartë i Prokurorisë, duke u nisur nga parashikimi i dispozitave konkrete të Kodit të Procedurës Penale dhe Kodit Penal, çmon se midis togfjalëshave “*..dënim me burgim jo më pak, në maksimum, se shtatë vjet*” dhe “*gjer në shtatë vjet*” apo “*deri në shtatë vjet*” nuk rezultojnë të ketë dallim kuptimor, që justifikon përjashtimin e këtyre veprave penale nga mundësia për të përdorur metodën e përgjimit për zbulimin e së vërtetës gjatë hetimit penal.
- 30.1 Nisur nga argumentet e parashtruar më lart, Këshilli i Lartë i Prokurorisë arrin në përfundimin se Udhëzimi i Përgjithshëm Nr. 1, datë 25.01.2023 “*Për aplikimin e drejtë të normës procedurale nga prokurorët në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë*”, është i ligjshëm dhe për rrjedhojë detyrues dhe zbatueshëm nga prokurorët të cilët i drejtohet.
- 31.1 Duke marrë shkak nga çështja objekt shqyrtimi, Këshilli i Lartë i Prokurorisë vlerëson se ekziston mundësia për një praktikë jo të njëjtë për zbatimin e kufirit ligjor të përgjimeve ndërmjet prokurorëve të juridiksionit të përgjithshëm dhe të posaçëm, për rrjedhojë është e nevojshme që nga Prokurori i Përgjithshëm të unifikohet dhe të disiplinohet kjo problematikë në nivel kombëtar.

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, mbështetur në nenin 47, pika 1 të ligjit Nr. 97/2016 “*Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë*” i ndryshuar dhe nenit 90 të Kodit të Procedurave Administrative,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e ankesës së prokurorit Ilir Hoxha kundër Udhëzimi i Përgjithshëm Nr. 1, datë 25.01.2023 “*Për aplikimin e drejtë të normës procedurale nga prokurorët në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë*”, si të pabazuar në ligj dhe në prova.
2. Të njoftohet për këtë vendim prokurori Ilir Hoxha, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe Prokurori i Përgjithshëm.

SEKRETA

3. Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi menjëherë e publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
4. U shpall në Tiranë, më 21.03.2023.



**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË**

**KRYETAR**  
Alfred Balla

**ZV/KRYETAR**  
Tartar Bazaj

**ANËTAR**  
Sokol Stojani

**ANËTAR**  
Bujar Sheshi

**ANËTAR**  
Nurihan Seiti

**ANËTAR**  
Elaida Goxhi

**ANËTAR**  
Esmeralda Keshi

**ANËTAR**  
Zeqir Hoda  
Kundër

**ANËTAR**  
Mirela Bogdani

**ANËTAR**  
Arta Mandro

**ANËTAR**  
Ledina Riza